

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, me Trupin Gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtari Ndërkombëtar Gianfranco Gallo dhe Gjyqtari Kosovar Isa Kelmendi si anëtarë, të ndihmuar nga procesmbajtësja Vlora Johnston, në lëndën penale kundër të akuzuares

F.B., lindur me datë 12/3/1967 në fshatin Dolle (Klina), bijë e *B.K.* dhe *S.B.*, shqiptare kosovare, e martuar dhe nënë e 3 fëmijëve, ka mbaruar shkollën fillore, shtëpiake, gjendje e mesme financiare, më parë e padënuar, e përfaqësuar nga avokati Zeqir Berdynaj;

Akuzuar sipas Aktakuzës PP. Nr. 2002/2007 data 2/8/2007 për veprën penale në vijim:

Vrasje sipas nenit 146i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës sepse me datë 24 maj 2007, në orën 8.15, në fshatin Gjurgjevik i Madh (Komuna e Klinës), në odën e mysafirëve në shtëpinë e saj, F.B. me dashje ka vrarë M.B., bujk, 28 vjeç, nga i njëjti fshat..

Ne veçanti, F.B. ka vërejtur të ndjerin M.B. të hyjë në shtëpinë e saj, ajo ka shkuar në dhomën e fjetjes dhe ka marrë pushkën e gjuetisë GA, numri serik 146143, kalibër 12 mm, dhe ka shkuar në dhomën e mysafirëve dhe nga një distancë prej 2 metrash ka qëlluar M.B. në krahator dhe pasi që viktimi është rrëzuar në dysheme, e akuzuara ka qëlluar dy herë në shpinën e tij duke shkaktuar kështu vdekjen e M.B. si rezultat e plagëve të marra nga të shtënat me armë.

Ky krim ndëshkohet me pesë deri në njëzet vjet burgim.

Pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit kryesor me datë 15, 16, 22 shtator, 11 nëntor, 1, 3 dhe 14 dhjetor në praninë e:

- Të akuzuarës *F.B.* dhe avokatit të saj mbrojtës Z. Zeqir Berdynaj;
- Prokurores Publike Znj. Gjemajlije Mustafa;
- Palës së dëmtuar Z. *A.B.*;

Pas shqyrtimit për marrjen e vendimit nga trupi gjykues dhe votimit të mbajtur me datë 14 dhjetor 2009, bazuar në nenin 391, Paragrafi (1) i KPPK-së,

Me datë 14 dhjetor 2009 sipas nenit 392 Paragrafi (1) i KPPK-së, në prani të publikut dhe të akuzuarës shpall si në vijim:

AKGJYKIM

F.B. shpallet

FAJTORE

Për veprën penale të Vrasjes së *M.B.*, në pajtim me nenin 146 të KPPK-së, kryer në Gjurgjevik të Madh me datë 24 maj 2007

Për këtë arsye i akuzuari

DËNOHET

Me **DHJETË (10)** vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga e pandehura është zbritur nga dënimi për veprën penale të mbajtjes dhe posedimit të paautorizuar të armëve.

E akuzuara do të paguajë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) i KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Në momentin e marrjes së këtyre të dhënave dhe në pajtim me nenin 100 paragrafi 2 i KPPK-së do të merret një vendim i veçantë lidhur me shumën e shpenzimeve.

Në pajtim me nenin 112, paragrafi 2 KPPK, e pandehura

OBLIGOHET

Të paguajë shumën prej € 10.000,00 (dhjetë mijë) palës së dëmtuar, si kompensim i pjesshëm për dëmet e shkaktuara. Gjykata udhëzon palën e dëmtuar se ajo mund të vazhdojë pjesën tjetër të kërkesës për kompensim në një padi civile.

Emri: Aktgjykimi,

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 2 of 27

ARSYETIMI

1. Prapavija faktike dhe hapat proceduralë

Me datë 24 maj në orën 8:18 (apo 8:20 sipas një tjetër raporti të policisë¹) Stacioni i Policisë në Klinë ka marrë një telefonatë nga V.B. bashkëshort i F.B. Ai ka raportuar se pak më parë F.B. kishte vrarë me armë zjarri M.A.B. kushëriri dhe fqinji i tij. Sipas V.B., vrasja kishte ndodhur në shtëpinë e tij (pronë e babait të tij B.B.) në fshatin Gjurgjevik i Madh.

Policia ka arritur disa minuta më vonë (8:30) në vendin e ngjarjes dhe e ka siguruar atë. Kjo është vendngjarja e parë nga oficerët:

- Pas kalimit të derës së oborrit të V.B. (ku kishte ndodhur vrasja) mund të shihej e pandehura, ulur në majë të shkallëve që gjenden menjëherë në anën e majtë të derës së oborrit². Shkallët çojnë në odën e burrave (e ashtuquajtur oda e mysafirëve). E pandehura kishte në duart e saj një pushkë gjuetie dhe në xhepat e saj gjendeshin 4 plumba gjuetie të kalibrit 12 and 2 gëzhoja të të njëjtit kalibër³.
- V.B. dhe nëna e tij ishin të pranishëm në oborr që gjendet përballë ndërtesës ku qëndronte F.B.⁴; Që të dy ishin duke qarë;
- Nga maja e shkallëve ku qëndronte F.B. shihej oda e burrave. Kjo odë e burrave përbëhej nga një hyrje (përmendur më poshtë si “paradhomë”) dhe oda e burrave. Trupi i pajetë i M.B. gjendej në anën e djathtë të odës së burrave siç shihet nga hyrja e dhomës së mysafirëve⁵. Ai ishte i shtrirë në dysheme, me fytyrë poshtë, me kokë në drejtim të murit përballë hyrjes. Ai kishte tre plagë të shkaktuar nga armë zjarri, një në bark, një në shpatullën e majtë dhe një në shpinë;
- Në dysheme në “dhomën e mysafirëve” janë gjetur pjesë të kapakut që mbështjell plumbat për gjueti që janë qëlluar (të hedhur gjatë të shtënave): këto sende janë konfiskuar;
- Në muret e dhomës, pas trupit, hetuesit kanë vërejtur gërvishje dhe prishje të sipërfaqes së murit shkaktuar nga saçmet e të shtënave nga pushka për gjueti.

¹ Shih raportet e policisë të datës 24.5.2007 të nënshkruar nga oficerët Sahibe Shala dhe Refki Krasniqi

² Bashkangjitur aktvendimit si shtojcë “A” gjendet një skicë e shtëpive ku jetojnë familjet e së pandehurës dhe të viktimës. Është e njëjta skicë që është përdorur nga dëshmitarët për të përshkruar situatën.

³ Pushka, plumbat dhe gëzhojat janë konfiskuar nga policia.

⁴ Shih për këtë raportet e policisë të cituara më lart.

⁵ Bashkangjitur me aktgjykimin si shtojcë “B” gjendet një skicë e odës së mysafirëve me vendndodhjen e saktë ku gjendeshin sendet në momentin e konfiskimit. Kjo është nxjerrë nga raporti i Forensikës dhe i është treguar dëshmitarëve gjatë ekzaminimit të tyre, për nevoja të qartësimit.

F.B. dhe *V.B.*, të konsideruar si të dyshuar, janë arrestuar dhe kundër tyre Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ka filluar procedurë penale përmes vendimit PPHQ.nr.56/07 i datës 25.05.2007, pas një kallëzimi penal përpiluar nga Policia e Kosovës, Shtabi Qendror Rajonal – Njësia Hetuese, numri i lëndës 2007-DE-491, numri i referencës 2007-HRP-022 data 25.05.2007.

Në vazhdim, hetimet janë zhvilluar më ngadalë. Kështu:

- Ekzaminimi i parë i *F.B.* nga Prokurori Publik është bërë me datë 26.7.2009 (vetëm dy muaj pas vrasjes);
- Është mbajtur vetëm një përmbledhje e procesverbalit;
- Nuk është bërë ekzaminimi i shenjave të gishtave që gjendeshin në thikë, pa ndonjë arsye, (dhe Gjyqtari i Procedurës Paraprake do të duhej të kishte urdhëruar një ekspertizë të tillë);
- Prokurori Publik nuk ka urdhëruar ekspertizën e mbetjeve nga të shtënat me armë edhe pse policia kishte marrë mostra të parafinës nga të dy; e pandehura dhe *V.B.* (dhe përsëri Gjyqtari i Procedurës Paraprake do të duhej të kishte urdhëruar ekspertizën e këtyre mostrave);
- Në shqyrtimin kryesor të parë nuk është marrë raporti nga anatomopatologjisti.

Në fund, prokurori ka përfunduar hetimet kundër *V.B.* dhe ka ngritur Aktakuzën PP.nr.202/07 data 02.08.2007 vetëm kundër *F.B.*, duke akuzuar atë për veprën penale të *Vrasjes* në pajtim me nenin 146 KPK dhe për veprën penale të *Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve* në pajtim me nenin 328 paragrafi 2 KPK.

Sipas aktakuzës, e pandehura *F.B.* me datë 24 maj 2007 rreth orës 08:15, në shtëpinë e saj në fshatin Gjurgjevik i Madh, më saktë në dhomën e burrave, me dashje ka vrarë *M.B.*, 28 vjeç, duke e qëlluar atë tre herë me një pushkë gjuetie nga një distancë prej dy metrash, një herë në pjesën e përparme të trupit dhe dy herë në shpinë, pasi që ai ishte rrëzuar në tokë. Për më tepër ajo është ngarkuar për përdorim të paautorizuar të pushkës për gjueti të cilën ajo ka përdorur për të vrarë *M.B.* Pushka për gjueti mbahej me leje nga bashkëshorti i saj *V.B.*, numri i lejes ERC-03-19476, data e skadimit 10 shkurt 2008.

Aktakuza është konfirmuar me datë 18 shtator 2009 me vendimin KAQ.nr.217/07.

Gjyqi i parë është mbajtur me dyer të mbyllura me datë 21, 22, dhe 23 janar 2008. Kjo rezultoi në lirimin e të pandehurës nga akuza për vrasje dhe në dënimin e saj për Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim i armëve dhe dënuar me tetë muaj burgim, me vendimin P.nr.606/07 datë 23.01.2008. Trupi Gjykues ka pranuar se vrasja është kryer nga *F.B.* në mbrojtje të nevojshme. Prokurori Publik dhe pala e dëmtuar kanë ushtruar ankesë kundër këtij vendimi.

Emri: *Aktgjykimi,*

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 4 of 27

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur mbi ankesën ka nxjerrë vendimin Ap.nr.333/2008 datë 05.02.2009, i cili konfirmon aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me shpalljen fajtor dhe anulon atë për sa i përket lirimit nga akuza e vrasjes dhe dërgon lëndën për rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Sipas vendimit të Gjykatës Supreme:

- Vendimi i shkallës së parë është marrë, duke u bazuar, mes deklaratave të tjera, në deklaratat e *B.B.* dhe *F.B.*, të cilët sipas ligjit ishin të liruar nga detyra për të dëshmuar në pajtim me nenin 160 para. 1 pika 2 KPPK, dhe ata kanë ushtruar këtë të drejtë të tyre gjatë shqyrtimit kryesor duke mos dëshmuar, ka shkelur nenin 403 para. 1 pika 8 dhe 12 KPPK.
- Në gjykimin e parë faza e procedurës është dëmtuar nga mungesa e ekspertizës së shenjave të gishtave (në thikën e gjetur nga Policia afër krahut të majtë të viktimës) dhe nga mungesa e një raporti autopsie, edhe pse në dosjen e lëndës gjendeshin fotografi të marra gjatë autopsisë;
- Gjykata e shkallës së parë nuk dhënë në mënyrë të duhur arsyet që mbështesin ekzistencën e mbrojtjes së nevojshme.

Kështu, Gjykata Supreme ka urdhëruar gjykatën e shkallës së parë, me rastin e rigjyimit, që të marrë analizat eksperte të lartpërmendura dhe të vlerësojë ato në lidhje me mbrojtjen e *F.B.* (dhe në veçanti lidhur me pretendimin për mbrojtje të nevojshme). Duhet të shtohet gjithashtu se vendimi i Gjykatës Supreme i është referuar (si pasojë e një gabimi procedural) nevojës për të marrë përfundimet e "ekspertit të toksikologjisë" lidhur me ekzistencën e mundshme në trupin e viktimës të "*substancave inorganike që mund të jenë konsumuar nga viktimja përpara aktit të vrasjes, respektivisht, që mund të jenë vendosur në një mënyrë të dhunshme në trupin e viktimës pas aktit të vrasjes*". Fakti që kjo ka të bëjë me një gabim procedural qartësohet edhe nga fakti se:

- Dosja e lëndës nuk përmban asnjë kërkesë të paraqitur nga gjyqtari i procedurës paraprake për ndonjë ekspert në toksikologji dhe se
- Një ekspertizë e tillë nuk kishte të bëjë fare apo nuk do të shtonte asgjë hetimeve lidhur vdekjen (me armë zjarri) e dhunshme që po shqyrtohej.

Kjo pjesë e vendimit të Gjykatës Supreme nuk është marrë parasysh në momentin e rigjyimit.

Pas kthimit të lëndës në Gjykatën e Qarkut në Pejë, pala e dëmtuar ka parashtruar një kërkesë Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it që të marrin lëndën për gjykim. Me datë 8 prill 2009 me anë të vendimit të Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, lënda i është dhënë gjyqtarëve të EULEX-it për rigjykim. Shqyrtimi kryesor është mbajtur me dyer të mbyllura me datë 15, 16, 22 shtator, 11 nëntor, 1, 3 dhe 14 dhjetor 2009, në praninë e të pandehurës Znj. *F.B.*, avokati i saj mbrojtës Z. Zeqir Berdynaj, Prokurori Publik Znj. Gjemajlije Mustafa dhe pala e dëmtuar Z.

A.B.

Përpara fillimit të gjyqit Kryetari i Trupit Gjykues kishte kërkuar nga Instituti i Forensikës në Prishtinë, raportin e autopsisë i përpiluar nga patologu Dr. Arsim Gerxhaliu me datë 25 maj 2007, pas autopsisë së viktimës *M.B.*

Gjatë seancës së parë, Kryetari i Trupit Gjykues, në praninë e palëve ka lëshuar urdhrat në vijim (në pajtim me përmbajtjen e vendimit të Gjykatës Supreme):

- Urdhër për ekspertizë balistike të pushkës së gjuetisë,
- Urdhër për ekzaminimin e shenjave të gishtave në thikë dhe në gëzhojat e pushkës së gjuetisë, dhe
- Urdhër për ekspertizën e mostrave të barutit të marra nga duart e të pandehurës *F.B.* dhe ato të *V.B.*
- Urdhër për marrjen e matjeve të thirrjeve telefonike për numrat 044/431-563, 044/729-625 dhe 044/744-114

Me datë 29 shtator 2009 Kryetari i Trupit Gjykues ka nxjerrë një urdhër tjetër për Burgun e Dubravës dhe Qendrën për Paraburgim në Pejë, që ti sigurojnë Gjykatës listën e personave që kanë vizituar *M.B.* gjatë kohës së tij në burg, paraburgim. Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët/dëshmitarët ekspertë në vijim:

- a) *H.B.* si dëshmitar me datë 16 shtator 2009;
- b) *S.T.* si dëshmitare me datë 16 shtator dhe me 03 dhjetor 2009;
- c) *R.B.* si dëshmitare me datë 16 shtator 2009;
- d) *A.B.* si dëshmitar me datë 16 shtator dhe me 03 dhjetor 2009;
- e) *A.G.* si dëshmitar/ekspert me datë 17 shtator 2009;
- f) *A.B.* si dëshmitar me datë 22 shtator dhe me 03 dhjetor 2009;
- g) *M.B.* si dëshmitare me datë 22 shtator dhe me 03 dhjetor 2009;
- h) *V.B.* si dëshmitar me datë 22 shtator dhe me 03 dhjetor 2009;
- i) *V.B.* si dëshmitar me datë 22 shtator 2009;
- j) *F.L.* si dëshmitar/ekspert me datë 11 nëntor 2009.

E pandehura nuk ka mund të ekzaminohet nga trupi gjykues, sepse ajo ushtruar të drejtën e saj për të qëndruar në heshtje në pajtim me nenin 356 para. 2 pika 1 KPPK. Duhet të konstatohet se ajo ka përdorur të drejtën e saj për të qëndruar në heshtje dhe ka deklaruar se në çdo rast ajo i është referuar deklaratave të saj të dhëna gjatë gjykimit të parë. Pas pëlqimit të palëve, deklaratat/dokumentet në vijim janë konsideruar si të lexuara në shqyrtimin kryesor:

- Kallëzimi penal, datë 24-05-2007
- Raporti i policisë, raporti fillestar i incidentit, datë 24-05-2007
- Raporti i oficerit i datës 24-05-2007
- Raporti i policisë hetuese, datë 24-05-2007
- Raporti i policit hetues, datë 24-05-2007
- Raporti i vendngjarjes, datë 24-05-2007
- Skica e vendngjarjes dhe legjenda e përpiluar nga Oficeri i policisë Blerim Tigani, pa datë
- Albumi i fotografive të vendngjarjes përpiluar nga oficeri i policisë Valbona Kralani
- Raporti i oficerit të policisë që ka marrë pjesë në autopsi
- Albumi fotografik i autopsisë
- Skica të shtëpive të familjes *B.* bërë nga Oficeri i policisë Enis Boshtrakaj
- Fotografi të marra nga aparati i viktimës, në veçanti një fotografi e të pandehurës të cilës i janë referuar palët, e pandehura është gjysmë e ç'veshur
- Raporti i policisë, datë 03-06-2007
- Deklarata e *V.B.*, datë 26-07-2009 dhënë përpara Prokurorit Publik
- Raporti i autopsisë nga Arsim Gerxhaliu
- Raporti balistik 13-10-2009
- Raporti i ekzaminimit të shenjave të gishtave, datë 13-10-2009
- Raporti i ekzaminimit të mbetjeve të të shtënave, datë 18-11-2009
- Përgjigje nga Burgi i Dubravës dhe Burgu i Pejës lidhur me vizitat që i janë bërë *M.B.*, datë 05-10-2009.
- Matje e thirrjeve telefonike për numrat 044-431 563, -729 625 dhe -744 114
- Zarfi me SIM kartelë, dhe letrat relevante të dhëna trupit gjykues gjatë shqyrtimit kryesor
- Vërtetimi i konfiskimit të armës, datë 24-05-2007
- Vërtetimi i konfiskimit të thikës së kuzbinës gjetur në vendngjarje, datë 24-05-2007
- Raporti mjekësor i Spitalit Rajonal në Pejë, datë 24-05-2007
- Raporti mjekësor i Qendrës së Shëndetit për Mjekësi Familjare në Klinë, datë 24-05-2007

Pas shqyrtimit për marrjen e vendimit, në seancën e datës 14 dhjetor 2009 është lexuar Vendimi, në prani të të pandehurës.

Emri:

Aktgjykimi,

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 7 of 27

2. Ligji i aplikueshëm, kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e Trupit Gjykues

2.1. E akuzuara akuzohet për vrasje sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm të Kosovës. Kjo veprë penale dënohet me jo më pak se pesë vjet burgim dhe (në pajtim me nenin 38 para.1, KPPK) me jo më shumë se 20 vjet.

2.2. Në pajtim me nenin 23 para.1 i Kodit të Përkohshëm të Kosovës (tani e tutje KPPK), Gjykatat e Qarkut kanë kompetencë të gjykojnë në shkallë të parë veprat penale që ndëshkohen me të paktën 5 vjet apo burg afatgjatë. Gjykata e Qarkut në Pejë ka kompetencë territoriale meqenëse fshati Gjurgevik i Madh është pjesë e komunës së Klinës që bie nën juridiksionin e Gjykatës së Qarkut në Pejë.

2.3. Vepra Penale është në kuadrin e nenit. 3, paragrafi 3, nga Ligji mbi Juridiksionin (3 – L053/2008), parashtron kompetencat plotësuese/ndihmese për Gjyqtaret e EULEX-it. Neni 3 paragrafi 3 thekson se në raste kompetencash plotësuese Gjyqtaret e EULEX-it mund të marrin çështjen me emërim të Kryetarit të Gjyqtareve të EULEX-it, sipas kërkesës së cilësdo pale në procedure, ose nga presidenti i Gjykatës përkatëse, për ndonjë arsye kur kjo është konsideruar e domosdoshme për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë.

Në këtë çështje dy Gjyqtarë të EULEX-it janë emëruar nga Kryetari i Gjyqtareve të EULEX-it në 8.4.2009, sipas kërkesës së Ushtruesit të Detyrës së Kryetarit të Përkohshëm të Gjykatës së Qarkut në Pejë për të zëvendësuar gjyqtaret lokale me gjyqtare të EULEX-it. Gjyqtari Kosovar ka qene pjese e Kolegjit gjate tere Gjykimit ne përputhje me nenin 4.7 te Ligjit mbi Juridiksionin. Është për të shtuar *in limine litis* (që në fillim të Gjykimit) që palët nuk kanë pasur kundërshtime për përbërjen e Trupit Gjykues.

3. Meritat e çështjes

Kolegji vërteton në fund të gjykimit kryesor që fajësia e **F.B.** është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe si rrjedhojë ajo duhet të konsiderohet përgjegjëse për vrasjen e **M.B.**, bazuar në elementet e mëposhtme.

3.1. Rrëfimi i **F.B.**

E pandehura u rrëfye në disa raste (përpara prokurorit publik në 26.7.2007 dhe përpara Trupit të parë Gjykues në 23 Janar 2008) që ka vrare **M.B.**. Te dy rrëfimet ishin formale dhe plotësisht të pranueshme, të riprodhuara, në vazhde të

paralajmërimi te domosdoshme ne praninë e avokatit mbrojtës⁶. Si rrjedhojë është e nevojshme te vlerësohet nëse rrëfimet e riprodhuara te **F.B.** mund te shihen si te besueshme apo jo. Ne këtë nivel se pari (nga perspektiva e përgjithshme) trupi gjykues konsideron qe rrëfimi është një lloj prove verbale e rëndësishme, ne te cilat njohuria për ngjarjet nuk rrjedh nga kujtesa apo perceptimi dëgjimor i një personi te trete, ne lidhje me fakte te kryera nga te tjerët, por ne fakt nga eksperiencia e drejtpërdrejtë e autorit te deklaratës lidhur me diçka te kryer nga ai/ajo vete. Ne Kodin aktual te Procedurës Penale, nuk ka asnjë rregull qe ti atribuohet paravendosjes, se vlerave ligjore (detyruese) te provave ne rrëfime. Kjo do te thotë qe Gjykatësi duhet qe lirisht te vlerësojë peshën dhe besueshmërinë qe i atribuohet kësaj (provës). Kjo natyrisht, brenda kufijve te arsyetimit te logjikshëm dhe është detyre për gjyqtarin te paraqes arsye për vendimin e tij. E sipërpërmendura detyron qe si i tille, si dhe nga aspekti teknik:

- nga një ane rrëfimi nuk kërkon domosdoshmërisht konfirmim te jashtëm ne mënyrë qe aktgjykimi te bazohet ne te (edhe ne rast se siç shihet me tej, procedura e provave ne procedurën ne fjale ka mundësuar një sere elementesh te konfirmimit te brendshëm dhe te jashtëm.

- nga ana tjetër, edhe pse një rrëfim mund te mos merret parasysh nga trupi gjykues kurdo qofte për arsye logjike kjo nuk mund te merret ne konsiderate si e sigurte..

Natyrisht, ne vlerësimin e rrëfimit gjyqtari duhet te mbaje parasysh rregullat e eksperiencës se përgjithshme, sipas se cilës, nuk ka gjasa qe një person te akuzoje vetveten për vepër penale (si rrjedhim te marre dënimin e rende si pasoje, për veprën e kryer), veç nëse ai/ajo vërtet e ka kryer këtë: sidoqoftë qe kjo natyrisht nuk e lehtëson kolegjin nga detyra për te vlerësuar përmbajtën dhe besueshmërinë e rrëfimit ne mënyrë qe te përjashtojë mundësinë e mashtrimit. Përfundimisht kolegjii konsideron qe përmbajtja e rrëfimit – nëse është e nevojshme te vlerësohet ne mënyrë te shumëllojshme (për shembull; te konsideroje një pjese te besueshme e një pjese jo) atëherë kur këto pjese nuk interferojne me njëra – tjetrën, deri sa gjyqtari te paraqesë arsyetim te mjaftueshëm për zgjedhjen e tij.

Sa i përket vlerave te rrëfimit; përpara Prokurorit Publik **F.B.** ne 26.7.2007, theksoi;

- se marrëdhënia e familjes se saj me familjen e **M.B.** ka qene gjithnjë e mire dhe e qete.

⁶ Duke qene përgjegjëse për krimin (ja vlen te përmendet qe) gjithashtu menjëherë pas arrestimit **F.B.** rrëfeu përpara polices Saibe Shala qe ishte me te.

- një vit pas luftës, ndërsa ishte ne stallën e lopëve (qe gjendet disa qindra metra nga shtëpia e saj) M. hyri i armatosur dhe e urdhëroi atë qe ti jepte para⁷. Pasi i tha atij qe nuk kishte para, ai e përdhunoi atë dhe e urdhëroi qe te mos tregonte askujt për këtë, duke e kërcënuar seriozisht ne rast se ajo nuk bindej;
- ne vitet ne vazhdim M. e përdhunoi F.B. dhe dy here te tjera, duke shfrytëzuar mungesën e anëtarëve te familjes se saj.
- pas përdhunimit te dyte, F.B. ju drejtua nënës se M., e i tregoi për sjelljen e djalit te saj, M. Nena e M. ju lut asaj qe te mos i tregonte askujt për këtë, dhe se ajo do gjente një zgjedhje;
- F.B. nuk i tregoi kurrë familjes se saj për këto ngjarje;
- ne ditën kritike, ndërsa ajo ishte duke punuar ne oborr, M.B. hyri ne oborr dhe shkoi drejt odes se burrave e gjendur ne katin e dyte te shtëpisë se F.B. Duke pare këtë, F. hyri ne apartamentin e saj (ne katin e pare te se njëjtës shtëpi), ku ajo mori armen e te burrit te saj dhe u nis drejt odes se burrave. Ajo kishte për qellim te frikësonte M.B., ne mënyrë qe ta dis-inkurajonte nga ndonjë kërcënim i mëtejshëm.
- Kur ajo hyri ne dhome, M. po shihte nga dritarja. Ajo qëllloi për here te pare ne drejtim te gjoksit te tij nga një distance prej 2-3 metra dhe ai ra menjëherë ne toke.
- F.B. nuk i kujtohet nëse ajo ka shtënë dhe here re tjera⁸ apo jo; asaj i kujtohet qe ishte ulur ne shkalle duke mbajtur armen kur sheh qe ne oborr me pas burrin e saj dhe nënën e tij.
- fotografia e saj lakuriq e gjendur ne kamerën e M.B., ishte bere nga M. me qellim për te pasur mundësi te tjera shantazhi, ne rast se ajo do i tregonte dikujt për rastin;
- ajo nuk e dinte se prej ku e kishte marre M.B. thikën qe gjendej ne toke anash tij.

Përpara trupit gjykues, ne rastin e Gjykimit te pare kryesor, e pandehura e përsëriti sekuencën e mësipërme te ngjarjeve, edhe pse me veçantit e ndriçuara me poshtë. Duhet theksuar qe marrja ne pyetje nga trupi gjykues ka qene me e detajuar krahasuar me marrjen ne pyetje përpara Prokurorit Publik.

⁷ E pandehura shtoi se M. pre-supozonte qe F. kishte para pasi anëtarët e familjes se saj jetonin dhe punonin jashtë shtetit.

⁸ Kur është marre ne pyetje nga Prokurori Publik ne 26.7.2007 F.B. theksoi "Kur hyra ne dhome M. ishte përpara dritares duke pare jashtë. Atëherë unë me armen tashmë te mbushur ne dhome qëllova një here ne drejtim te gjoksit te tij nga një distance prej 2-3 metra. Vura re qe ai ra ne toke dhe me pas nuk me kujtohet nëse kam qëlluar me arme dhe here te tjera apo jo". E njëjta rrethane është konfirmuar përpara trupit te pare gjykues, edhe pse duke shtuar qe F.B. po shihte M.B. qe kishte rene ne gjunjë.

Përdhunimi i pare ndodhi ne 2003-shin (dhe jo ne 2000-shin, siç ka dëshmuar **F.B.** përpara Prokurorit Publik, një muaj e gjysmë përpara se **M.B.** te hynte ne burg;

- te nesërmen e asaj dite ajo vendosi te fliste me nënën e **M.** lidhur me çfarë kishte ndodhur (dhe jo pas përdhunimit te dyte siç është dëshmuar përpara Prokurorit Publik);
- përdhunimi i dyte ka ndodhur pasi ai kishte dale nga burgu;
- dy ose tre jave me pas nena e **M.** vdiq, **M.** e ka përdhunuar ne dhomën e miqve. Pas përdhunimit, ai i beri asaj një fotografi me kamerën e tij, duke e kërcënuar se do ta shpërndante ne internet ne rast se ajo do te tregonte për çfarë kishte ndodhur.

Ja vlen te përmbliidhen gjerësisht deklaratat (e bëra nga **F.B.** përpara trupit gjykues) lidhur ne veçanti me incidentin e vrasjes.

Ajo tha:

- qe nuk ishte qëllimi i saj te vriste **M.**, por vetëm qe ta bindte atë qe te mos shkonte ne shtëpinë e saj përsëri;
- qe kur pa qe ai shkoi lart ne dhomën e pritjes, ajo hyri ne shtëpinë e saj, mori armen e mbushi, dhe me pas ka shkuar lart ne dhomën e burrave, ku pa **M.** qe qëndronte përpara dritares, duke pare jashtë;
- qe sapo **M.** vuri re qe ajo po mbante arme, ai nxori thikën (me vone e gjetur ne vendin e ngjarjes anash trupit te **M.**), ndërsa me dorën tjetër ai u përpoq te merrte revolen e tij.
- pikërisht ne këtë moment kur ai ishte dy hapa ne distance larg saj, **F.B.** qëlloi, duke mos marre atë ne shenje por ne drejtim te dritares.
- qe pas te shtënës se pare **M.** ra ne gjunjë.
- Qe ishte e pamundur për te qartësuar dhe sa here te tjera ajo ka shtënë, me qe ajo ishte "totalisht e pavetëdijshme".
- Qe ajo s'ka pasur biseda telefonike te mëparshme me **M.B.**

3.2. Vlerësimi i rrëfimit ne lidhje me elementet e tjera konfirmuese

Kolegji është i mendimit qe rrëfimi i **F.B.** është i besueshëm te paktën sa i përket pjesës kryesore (i.e. te paktën për faktin qe **F.B.** ka shtënë ndaj **M.B.**).

duke qene ky rrëfim shtylla kurrizore e kornizës se provave kundër te pandehurës, është e domosdoshme qe te provohen arsyet e sakta te një vlerësimi te tille. Kolegji është i mendimit qe elementet e rëndësishëm te jashtëm konfirmues kane dale gjate procedurës se provave. Ne te vërtetë:

Emri: *Atagjykimi,*

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 11 of 27

- Ne fakt vrasja është kryer brenda shtëpisë së **F.B.**, pikërisht në dhomën e miqve që ndodhet lart apartamentit ku ajo jeton me familjen e saj. Kjo mbart prova të rëndësishme përkatëse, pasi automatikisht përcakton kufijtë e mundshëm për dy dëshmitarë, në këtë rast **F.B.** dhe **V.B.**. Në fakt djemtë e **V.** dhe **F.B.** nuk ishin në shtëpi, kishin shkuar në shkollë, dhe **B.B.** (babai i **V.**) kishte dalë që në orën 8.00 të mëngjesit, ti shprehte ngushëllimet një familjeje tjetër. Në shtëpinë në fjale nuk jetonin persona të tjerë⁹.
- I pandehuri është gjetur nga Policia në vendin e ngjarjes menjëherë pasi kishte ndodhur vrasja. Ajo ishte në distance prej disa metrash nga trupi i vdekur i **M.B.** që ishte qëlluar tre here me pushkë gjuetie. Kjo i përshtatet shumë përshkrimit të të pandehurës (e cila përveç se që pranon të shtënë në pare, nuk mohon që mund të ketë qëlluar me shume se një here.
- Pushka (pushka e gjuetisë) që e pandehura kishte në duart e saj përshtatej me llojin e armës që kishte shkaktuar plagët që kishin rezultuar në vdekjen e **M.B.**¹⁰. Këto plage ishin krijuar vetëm minuta me pare (shih raportet e balistikës dhe koha e dhënë nga deklaratat e dëshmitarëve dhe raportet e policisë);
- E pandehura provoi që ishte e zonja për të shtënë me arme, për të rimbushur armen dhe për të shtënë përsëri në një kohë shume të shkurtër (25 sekonda¹¹), kështu duke e krahasuar me atë të të shoqit lidhur me kohën ndërmjet të shtënës së dyte dhe të trete¹²;

⁹ Natyrisht nga një pikëpamje abstrakte nuk mund të përjashtohet që një person i trete kishte hyre në shtëpinë e **F.B.** në të njëjtën kohë kur kishte hyre dhe **M.B.**, në mënyrë që ta vrisnin atë atje. Sidoqoftë në procedurat penale nuk mund të konsiderohen të gjithë shpjegimet e abstrakte të ndodhive, por vetëm ato që mund të shpjegojnë ngjarje me një shkallë të lartë besueshmërie racionale/të logjikutshme

¹⁰ Shih raportin e shkruar dhe marrjen në pyetje në gjykim (në gjykimin e dyte) të mjekut/anatomist Arsrim Gerxhaliu

¹¹ Shih deklaratat e dëshmitarit **F.L.** në rastin e marrjes në pyetje në 3 Dhjetor 2009. Ky është polici që ka kryer rikonstruksionin e vendit të ngjarjes dhe në atë rast mund të vinte re aftësitë e **F.B.** siç janë përshkruar dhe më lart.

¹² Lidhur me këtë, keni parasysh që në marrjen në pyetje të **V.B.** ai theksoi që në momentin e të shtënës së dyte me arme ai ishte në fund të shkalleve që të çonin në dhomën e miqve. Fillimisht ai u ngjiti në shkallë duke vrapuar e me pas me hapa të ngadalshëm. Pas kësaj ai i ngadalësoi hapat pasi nuk ishte i sigurt se çfarë po ndodhte në dhomën e miqve si dhe i frikësuar që mund ta qëllonin me arme. Vetëm pasi kishte kaluar paradhomën ai mundi të dëgjonte të shtënë në trete. Ky përshkrim i ngjarjeve është i pajtueshëm me kohën e kaluar prej rreth 25 sekondash ndërmjet të shtënës së dyte dhe të trete.

Emri: Aktgjykimi,

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 12 of 27

- Policia është telefonuar shume pak kohe pas vrasjes nga burri i te pandehurës (shih kohen e ngjarjeve ne raportin e policisë te gjendur ne dosjen e lendes dhe shqyrtoni gjithashtu deklaratat e V.B. lidhur me këtë). Kjo kohe shume e shkurtet ndërmjet nënkupton qe do te kishte qene ekstrem e vështirë për te pandehurën dhe burrin e saj (qe tërësisht pohoi faktet e dhëna nga ajo) ne teori, te kenë ndërtuar një strategji te përbashkët te versionit te fakteve/provave¹³;
- Kamera e viktimës M.B. kishte një fotografi te te pandehurës lakuriq, e marre nga afër, brenda dhomës. Ky fakt e bën te qarte se kishte pasur një lloj marrëdhënie seksuale ndërmjet F.B. dhe M.B., me force apo me dëshirë. E pandehura ka dale lakuriq duke mbajtur ne dore disa rrobe me qëllimin e dukshëm për tu veshur. Ajo duket e nxehur ne portret (edhe pse nuk është e mundur te elaborohet saktësisht mbi gjendjen mendore te te pandehurës ne atë moment). Kjo fotografi ishte bere pas vdekjes se nënës se M.B.¹⁴. Ajo vdiq rreth një muaj përpara ditës kritike. Fotografia ishte bere ne dhomën e miqve mbi apartamentin e F.B.¹⁵. edhe pse pamja e fytyrës se F.B. ne fotografi dhe qëndrimi i trupit te saj nuk ofrojnë ne vetvete, shenja te mjaftueshme për te konfirmuar përtej dyshimit te arsyeshëm se çfarë kishte ndodhur përpara se te behej fotografia, trupi gjykues konsideron qe rrethanat e mësipërme, përsëri janë te pajtueshme me përshkrimet e mundësura nga e pandehura.

¹³ Kjo e bën kolegjin te pajtohet me një tjetër pikëpamje, qe pajtueshmëria ndërmjet dy versioneve te F. dhe V.B. varet nga sinqeriteti i tyre se sa nga arritja e komplotit. Duhet te argumentohet ne nivele thjesht teorike, qe ndërmjet F. dhe V.B. ka pasur një komplot parandalues (sa i përket kryerjes se vrasjes, ose te paktën lidhur me, se kush do te merrte fajin për këtë vrasje) duke çuar kështu ne gatishmërinë e F.B. për te gënjer lidhur me përfshirjen e burrit te saj. Duhet shënuar qe ne dosjen e lendes nuk ka elemente specifike faktike qe te çojnë drejt kësaj, por vetëm një spekulim (bazuar ne kinse ekzistencën e marrëdhënies se dashurisë ndërmjet F. dhe M.B.). Për me tepër duhet pasur parasysh qe vetëm pranimi i ekzistencës se komplotit ndërmjet F. dhe M.B., e bën F.B. përgjegjëse, pjesëmarrëse ne vrasje ose te paktën si ndihmese ne vrasje (pasi përndryshe do te ishte e vështirë te shpjegohej mundësia e dy versioneve te njëjta nga F. dhe V.B., lidhur me ngjarjet e 24.5.2009.

¹⁴ Rrethanat janë bere te qarta nga fakti qe ne memorien e kamerës fotografia e përmendur me lart është bere pas fotografive te ceremonisë se vajtimit te trupit te nënës se M.B.

¹⁵ Te gjithë dëshmitarët e marre ne pyetje ne Gjykimin e dyte kryesor konfirmuan rrethanat (shih procesverbalin e seancës se datës 1 Dhjetor 2009): kjo krejtësisht zhvlerëson pretendimin e palës se dëmtuar A.B., sipas se cilit kjo foto ishte bere brenda apartamentit te M.B.. Për me tepër kjo hedh drite te negative lidhur me sjelljen e A.B. sa i përket Gjykimit aktual dhe tendencës se tij për te ekzagjeruar rrethanat kundër F.B. dhe burrit te saj me këndvështrim për te mbështetur pretendimet e ekzistencës se një marrëdhënie dashurie ndërmjet F. dhe M.B..

Emri: Akagjykimi,

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 13 of 27

- **F.B.** gjithnjë e ka pranuar përgjegjësinë e saj dhe asnjëherë (qe ne momentet e para te hetimeve) nuk është përpjekur për tu zbrapsur nga pohimet e saj. Po i njëjti qëndrim është mbajtur ne rastin e gjykimit kryesor, p.sh pasi ishte mbajtur ne burg për tete muaj.
- **V.B.** , burri i **F.B.** konfirmon ne detaje rrëfimin e te pandehurës.

Ne veçanti ai pohoi;

- Qe ne ditën kritike djemtë u nisen për ne shkollë rreth orës 7.30 te mëngjesit dhe babai doli rreth orës 8.00 te mëngjesit, ndërsa ai do qëndronte ne shtëpi deri sa te kthehej babai, qe pastaj te nisej për ne Prishtine. Hera e fundit qe ai pa gruan e tij ishte kur ata përshëndeten fëmijët ne orën 7:30;
- Ne kohen e te shtënave ai ishte punishten e tij ne bodrum qe e ka pamje nga oborri, ne anën e kundërt te shtëpisë familjare¹⁶, duke punuar për vendin e bletëve;
- Qe ai doli nga bodrumi vetëm pasi ai dëgjoji te shtënat. Ne fillim ai mendoi qe e shtëna erdhi nga diku tjetër jashtë shtëpisë se tij; kështu qe fillimisht ai u drejtua nga dera e oborrit, por kur arriti aty, ai dëgjoji te shtënën e dyte qe vinte nga dhoma lart e miqve (dera e te cilës ishte ne katin e sipërm anash me hyrjen e derës se oborrit)¹⁷;
- Si rrjedhoje ai u ngjiti me nxitim neper shkalle¹⁸, duke vrapuar ne gjysmën e pare e pastaj me hapa ne gjysmën e tij. Ndërsa arriti ne krye te shkalles, ai ndaloi, me kujdes, pa ditur se çfarë po ndodhte brenda dhomës dhe i preokupuar qe po ekspozonte veten ndaj rrezikut.
- Nga kreu i shkalleve ai mundi te shihte, ne qoshen e dhomës se miqve përtej “paradhomës” trupin e shtrire te **M.B.**¹⁹. Distanca ndërmjet atij dhe trupit ishte rreth 9-10 metra. pasi ndaloi ne hyrjen e “paradhomës” ai shkoi me kujdes drejt hyrjes se dhomës se miqve.

¹⁶ Distanca ndërmjet punishtes dhe shtëpisë se familjes ka qene rreth 50 metra; shih deklaratën e **V.B.** , date 22/9/09

¹⁷ Gjate marrjes ne pyetje, dëshmitarit i janë treguar disa foto te gjendura ne raportin e policisë dhe ne veçanti ka njohur fotot e shkalleve ne pyetje.

¹⁸ Sipas dëshmitarit shkalla ishte rreth 5 metra e gjate me 18-20 shkalle.

¹⁹ Për shpjegimin e fakteve dëshmitari ju referua vizatimit te bere nga hetuesi i policisë Blerim Tigani, te gjendur ne dosjen e lendes. Ai theksoi se gjendja e paraqitur ne vizatim korrespondoi pikërisht me gjendjen faktike te ditës kritike. **V.B.** shtoi qe ai ishte ne gjendje te dallonte qe trupi i shtrire ishte ai i **M.B.** vetëm pasi kishte hyre ne dhomën e miqve. Ai gjithashtu ju referua fotos numër 7 te gjendur ne raport te policisë te përgatitur nga Valbona Kralani, pjese e dosjes se lendes. Ai deklaroi qe gruaja e tij ishte duke qëndruar pak a shume ne vendin me etikete n. 4 te vendosur ne fotografi

Emri: **Aktgjykimi,**

Përkthyer nga:

- Vetëm pasi arriti te dera ai mundi te vinte re gruan e tij, ne anën e majte, pak a shume ne mes te dhomës se miqve, ne një distance prej tre metrash. Kur ai e pa atë ajo ishte gati për te qëlluar viktimën për here te trete²⁰
- Pas te shtënës se trete ai e mallkoi gruan dhe pastaj ju afrua për ta tërhequr nga vendi i ngjarjes, porse u tërhoq menjëherë, pasi ajo u kthye drejt tij, e shokuar, ne një mënyrë qe e beri atë te mendonte qe ajo mund te shkreppte armen aksidentalisht. Kështu qe ai e la gruan ne vendin e ngjarjes dhe shkoi poshtë ne mënyrë qe te merrte telefonin e ti telefononte policisë. Kur u kthye ai e pa gruan qe ishte ulur ne krye te shkalleve dhe e mallkoi përsëri, por nuk ju afrua pasi ne te njëjtën kohe nënës se tij i kishte rënë te fiket, nga tronditja;
- 3 - 5 minuta kaluan ndërmjet te shtënave dhe lajmërimit me telefon te policisë

V.B. ishte i vetmi person i pranishëm ne ngjarjen e 24.5.2007 (te paktën ne pjesën e dyte te saj). Trupi gjykues është ne dijeni qe

V.B. është hetuar me pare për te njëjtën vepër penale. Kjo rrethane edhe pse nuk shkakton detyrimisht një “dobësi” formale te deklaratës se tij (meqenëse akuzat kundër tij janë hedhur poshtë me vone) është për tu marre parasysh me faktin se V.B. është alternativa tjetër (rezultat grumbullues) e fajtorit te vrasjes; si rrjedhoje mund te ekzistoj një mundësi reale qe ai te synojte qe te fajësohet gruaja e tij ne mënyrë qe ti shpëtoj dënimit për vete²¹. Duhet pasur parasysh qe pavarësisht ekzaminimit te kujdesshëm te trupit gjykues, dëshmitari nuk ra ne kontradikta dhe ka qene me se i qëndrueshëm lidhur me faktet e ngjarjes²².

Ne çdo rast, duke pasur parasysh shqetësimet e mësipërme, dëshmia e V.B., edhe pse konfirmon rrëfimin e F.B., mund te merret vetëm si element i dobët mbështetës, ne krahasim me te tjerët përshkruar me pare.

²⁰ Dëshmitari deklaroi qe përpara te shtënës e pandehura lëvizte duart mbi pushke. Ai nuk ishte ne gjendje te kuptoi se për sa sekonda zgjati kjo, pavarësisht ekzaminimit intensiv nga trupi gjykues.

²¹ Turpi gjykues i vetëdijshëm për këtë mundësi alternative, ka shqyrtuar me shume kujdes alternativën e mundshme te përgjegjësisë se V.B. (duke supozuar versionin e mundësuar nga pala e dëmtuar, sipas se cilit ndërmjet F. dhe M.B. ka ekzistuar një marrëdhënie). Procedura e provave dhe dosja e lendes, sidoqoftë nuk kane mundësuar ndonjë element objektiv specifik ne atë drejtim.

²² Kjo është sidomos e vërtet ne lidhje me sekuencat e sakta te te shtënave ne 24 Maj 2009, ne te cilat kolegji i gjykimit u fokusua intensivisht.

- Dëshmitari ekspert *A.G.* mundëson elemente te mëtejshëm mbështetëse objektive te rrëfimit te *F.B.* (dhe te deklaratave te *V.B.*). Gjate seancave te 22.9.2009 ai deklaroi qe:
 - Qe brenda secilës prej tre plagëve është gjetur një numër saçmash (plumb i pushkës se gjuetisë) me kalibër 12²³. Gjithashtu brenda plagëve ishin gjetur disa pjese plastike qe formonin gëzhojat e armës se gjuetisë dhe te tapës plastike te gjendur brenda gëzhojës.
 - Patologu-anatomist qartësoj se te shtënat kane ardhur nga një distance te paktën me shume se 1 metër (ne lëkuren rreth plagës nuk ka pasur shenje te djegies. Ne te njëjtën kohe ai theksoi se distanca ndërmjet vrasësit dhe viktimës nuk mund te këtë qene me shume se pese metra, duke pasur parasysh gjerësinë e plagës dhe praninë e pjesëve plastike brenda plagës²⁴. Gjithashtu këto rrethana janë konstante me rrëfimin e *F.B.*
 - Dëshmitari ekspert ishte ne gjendje te përshkruante (ne mënyrë bindëse) sekuencën e vrasjes. Ne veçanti ai theksoi qe e shtëna e pare e ka goditur viktimën ne mëlçi, duke shkaktuar kështu tronditje te menjëhershme dhe gjakderdhje intensive, qe pasohet me rënien përpara te menjëhershme te *M.B.*. Ky rikonstruktim teknik i ngjarjeve përputhet me përshkrimin ne rrëfimin e *F.B.* (qe gjithashtu ne veçanti i kujtohet *M.B.* duke rënë ne gjunjë.)

Analizat e tjera te ekspertit me urdhër te trupit gjykues nuk kane shtuar asgjë ne strukturën e provave.²⁵

²³ I njëjti lloj i pushkës se gjuetisë qe është mbajtur nga e pandehura.

²⁴ Sipas dëshmitarit ekspert, nëse distanca do kishte qene me e madhe se ajo, nga njëra ane madhësia e plagës e shkaktuar nga plumbat saçme do kishte qene me e gjere nga ana tjetër, pjesët plastike te gëzhojave nuk do te kishin udhëtuar se bashku me plumbat saçme, por do te kishin marre drejtim tjetër.

²⁵ Ne veçanti, analizat e barutit nuk sollën rezultate sa i përket pranisë se gjurmëve te e pandehura dhe burri i saj. Ne këtë duhet evidentuar, qe mbledhja e mostrave te barutit është kryer nga policia ne një forme rudimentare (përdorim i tamponëve te pambukut) qe sipas se cilës, ajo qe ekspertet prisnin për trupin gjykues, pengoj analizat e duhura. Duhet shtuar qe analizat janë bere me shume se dy vjet përpara pasi janë marre mostrat e barutit te mbledhur. Ekzaminimi i shenjave te gishtërinjve nuk dha rezultate te gjurmëve papilare te kujtudo ne thike. Kjo edhe pse e çuditshme, mund te shpjegohet ose qe doreza e thikës ka qene një sipërfaqe e vrazhde, ose te pretendohet qe elementi prove është keqpërdorur. Ekspertiza balistike, ne vetvete, nuk ka mundësuar informacion shtese për trupin gjykues. Trupi gjykues gjithsesi, mundi te marre ne pyetje dëshmitarin, ekspertin e balistikes *F.L.*, duke marre informacion sa i përket kohës se rimbushjes se armës (deklaratat e tij janë nënvizuar me lart).

3.3. Elementet e rrëfimit dhe rëndësia e tyre

Tani është e domosdoshme për t'ju kthyer ekzistencës (ne rastin pohues) rëndësia e kontradiktave të mundshme brenda rrëfimeve dhe/ose ndërmjet dy versioneve të rrëfimeve të bëra nga e pandehura përpara prokurorit publik dhe trupit të parë gjyqësor. Për me tej do të vlerësohet ekzistenca shpjegimeve të tjera të mundshme të ngjarjeve të 24 Majit 2007.

3.3.1. Ekzistojnë një dy mospërputhje të vogla ndërmjet dy versioneve të rrëfimit. Duhet të nënvizohet se Trupi Gjyqësor ka dashur të marrë në pyetje gjatë gjykimit kryesor të dyte, në përpjekje për të marrë qartësi. Kjo nuk ishte e mundur, për shkak të zgjedhjes së F.B. për të qëndruar në heshtje gjatë gjykimit kryesor të dyte. Mospërputhjet kanë të bëjnë me (a) viti i sakte në të cilin episodet e para të raportuara të dhunës kanë ndodhur dhe (b) rastin kur F.B. vendosi të tregojë nënës së M. për çfarë kishte ndodhur.

3.3.2. Përpos çka u tha më lart disa nga rrethanat e paraqitura në rrëfim sipas mendimit të kolegjit, janë të çuditshme. Në pari, i bëhet referencë faktit që në ditën kritike, sipas përshkrimit të pandehurës, menjëherë dhe pa asnjë arsye të qartë M.B. është në shtëpinë e të pandehurës, pa leje, ai shkon në drejtim të katit të sipërm. Kjo sjellje e M.B. duket që nuk është shpjeguar tërësisht (se cili ishte qëllimi i tij kur u nis në dhomën lart?) Në dosjen e lëndës nuk gjenden elemente që mund të ndriçojnë këtë rrethanë. Në dyti, sjellja e të pandehurës gjithashtu, përpara pranisë së papritur të M.B. në shtëpinë e saj, duket e çuditshme, dhe në një mënyrë e ekzagjeruar (edhe duke pasur parasysh përshkrimin e përdhunimeve të mëparshme dhe pretendimin e saj për mbrojtje të nevojshme, pasi që kinse ishte përdhunuar nga viktima.

3.3.3. Lidhur me 3.3.2., duhet bërë një vërejtje shtese lidhur me vlerësimin e motiveve për të vrarë, ku besueshmëria e rrëfimit është vënë në pyetje nga pala e dëmtuar. Sipas palës së dëmtuar, në bazë të deklaratave të disa dëshmitarëve të afërm të tij (M.B.), (S.T., R.B., V.B., A.B.), F.B. dhe M.B. kanë qenë kinse të përfshirë në një relacion dashurie. Në veçanti:

3.3.3.1. Dëshmitarja **S.T.**, kunata e viktimës, qe jetonte ne një shtëpi me te, është burimi kryesor i informacionit²⁶. Sipas saj e pandehura dhe **M.B.** kane qene te përfshirë ne një marrëdhënie dashurie, e për këtë arsye ata takoheshin shpesh.

M.B. mund te hynte ne shtëpinë e te pandehurës nga kati i dyte i shtëpisë se tij, prej aty ai mund te hynte ne derën e oborrit te **F.B.**. Here te tjera (gjate pese muajve te fundit) ai mund te shkonte ne shtëpinë e te pandehurës përmes një çarjeje (vrime) te bere ne rrjetën e një dritareje. Sipas dëshmitares **F.** dhe **M.** kishin hapur "vrime kudo" ne mënyrë qe te takoheshin. Ajo vete i kishte pare ata bashke disa here ne oborr, afër me koliben e qenit.

S.T. shtoi qe ne një rast, rreth vitit 2000, ajo kishte pare **F.B.** dhe **M.B.** te putheshin ne buze²⁷. **S.T.** për me tepër shtoi se **F.B.** njëherë i kërkoi asaj qe te blinte për te një kartel telefoni, ne mënyrë qe te mbetej ne kontakt me **M.** kur ai ishte ne burg për vjedhje. **S.** kinse i besoj kunatit te saj **V.B.**, detyrën për ti blere kartën e telefonit. **V.B.**, i marre ne pyetje si dëshmitar ne 16 Shtator 2009, konfirmoi qe ai e kishte blere një karte SIM dhe ja kishte dhënë **S.T.**. **S.T.** tha qe ajo me vone ja kish dhënë këtë karte **F.B.**

3.3.3.2. Dëshmitarja **R.B.** është fqinje e **S.T.** dhe mikeshe e ngushte e familjes se viktimës (ajo deklaroi se nena e **M.B.** ishte për te si nena adoptuese). Ajo deklaroi se një here, behet fjale kur **M.** nuk ishte me shume se 17-te vjeçar (dhe **F.** ishte rreth 10 vjet me e madhe se ai) ajo i kishte pare ty dy duke u puthur pranë hangarit; shume here ajo kishte pare nga shtëpia e saj (me pamje nga oborri i **F.B.**) këta te dy te takoheshin (edhe pse deklaratat e saja përpara PP dhe trupit gjykues kanë kontradikta; sa i përket sjelljes reciproke te **M.** dhe **F.B.**; gjate këtyre takimeve; po ashtu edhe aftësisë se dëshmitares për te pare se çfarë po ndodhte gjate takimeve te pretenduara; si dhe lidhur me vendin e sakte ku ata pretendohet te jene takuar. E pyetur nga Kolegji nëse ajo kishte vene re sjellje te tjera te natyrës seksuale ndërmjet **F.** dhe **M.**, hiperbolikisht ajo deklaroi qe i kishte pare ata te putheshin "qindra e miliona here"

3.3.3.4. **A.B.** është vëllai i viktimës. Ai deklaroi (ne mënyrë përmbledhëse) qe e dinte se **M.** dhe **F.B.** kishin marrëdhënie se bashku për një kohe te gjate. Sidoqoftë i konfrontuar nga trupit gjykues, ai pranoi qe personalisht nuk kishte pare asgjë me tepër se sa qe e pandehura dhe **M.B.** bisedonin me njeri-tjetrin përmes gardhit ne oborr. Ai shtoi se një here ai foli me vëllanë e tij **M.** për ta shtyre qe te

²⁶ Shumica e dëshmitarëve te tjerë te lartpërmendur i janë referuar asaj si burimi i njohurive te hollësishme

²⁷ Dëshmitarja shtoi qe kjo "i shkaktoi asaj te përzier"

ndërpriste këtë marrëdhënie; pretendohet që M. është përgjigjur se nuk ishte faji i tij, por ishte F.B. ajo që i shkonte pas.

3.4. Vlerësimi i përgjithshëm

Gjatë vlerësimit të provave të lartpërmendura, Trupi Gjykses vë re si në vijim:

3.4.1. Elementet e konfirmimit të jashtëm, të theksuara nën 3.2 kanë ndër peshën më të madhe provuese. Është mendimi i Trupit Gjykses që mjafton një konfirmimi i tillë për të mposhtur mospërputhjet e shënuara nën sub 3.3.1. duhet të shtohet që mospërputhjet e tilla nuk kanë në vetvete rëndësi substanciale dhe prandaj nuk mund të ndikojnë në besueshmërinë e pranimit të fajit. Së pari, ato nuk u referohen thelbit të pranimit të fajit (p.sh. ngjarjet të 24.5.2007), por viteve të mëparshme dhe përdhunimeve të supozuara ndërmjet të pandehurës dhe M.B.

Së dyti, mund të konsiderohet edhe pranimi i një kujtese të pasaktë nga ana e të pandehurës lidhur me detalet (datat) që kanë të bëjnë me fakte të supozuara shumë vite më parë. Kjo mund të jetë e vërtetë sidomos sa i përket kornizës kohore të përdhunimit të parë, gjithashtu duke pasur parasysh që mekanizmat e kujtesës në një ngjarje kaq traumatizuese mund të pengohen apo të ndryshohen, duke e bërë kujtesën kështu më të pasaktë.

3.4.2. Sa i përket vlerësimit të rrethanave të sqaruara nën 3.3. dhe atyre të dëshmimeve të dhëna nga pala e dëmtuar (shih më lart 3.3.3 ff), një analizë e përbashkët është e dobishme duke e pasur parasysh gërshëtimin ndërmjet dy çështjeve. Trupi Gjykses vë re ekzistencën e elementeve të pabesueshmërisë në këto dëshmi. Ç'është e vërteta:

- Dëshmitarët (në veçanti S.T., R.B. dhe A.B.) treguan tendencë për të dëshmuar kundër versionit të të pandehurës, duke thënë që kishte pasur lidhje dashurie ndërmjet F. dhe M.B. Trupi Gjykses vë re tendencat e tyre të qarta për të zmadhuar rrethanat e lidhjes së supozuar të dashurisë ndërmjet F. dhe M.B.: kjo vërehet sidomos në të gjitha rrethanat në të cilat (sipas dëshmitarëve) e pandehura dhe M.B. kishin kontakte "seksuale". Për shembull, dëshmitarët (R.B. and S.T.) më shumë se një herë kanë deklaruar të kenë parë të pandehurën dhe M.B. duke u puthur "me miliona herë"²⁸ jashtë. Mirëpo, pas

²⁸ Sa i përket R.B., shih p.sh. proces-verbalin e datës 17 shtator 2009, faqe 28 dhe ballafaqimin pasues nga Kryetari i Trupit Gjykses.

ballafaqimit me Trupin Gjykues, u detyruan të zvogëlojnë në mënyrë dramatike numrin dhe kohëzgjatjen e këtyre rasteve²⁹. Qëndrim i njëjtë zmadhues shfaqet kur **S.T.** çuditërisht deklaroi se **F.** dhe **M.** takoheshin “pa e caktuar orën, mirëpo sa herë që **F.B.** ishte e lirë, ajo e thirrte **M.** dhe kërkonte që të takoheshin dhe ai linte autobusin pa konduktor, merrte taksi dhe shkonte tek ajo”³⁰. Për më tepër, dëshmitari **A.B.** fillimisht deklaroi se kishte parë të pandehurën dhe **M.B.** duke pasur marrëdhënie seksuale dhe pas ballafaqimit, ai e pranoi që i kishte parë vetëm “duke folur nëpërmjet gardhit”.

- Në një rast tjetër, dëshmitarja **S.T.** shfaqti sjellje të njëjta akuzuese duke deklaruar se **F.B.** i kishte thënë asaj (pa qenë e pyetur dhe pa një ndërlidhje të logjikshme në kontekst të narracionit) se kishte një lidhje dashurie me **M.** me dëshirën e saj dhe se *askush nuk po e detyronte*³¹. Trupi Gjykues e sheh këtë deklaratë spontane të supozuar të **F.B.** si të pabesueshme, madje edhe të palogjikshme, duke pasur parasysh faktin se tema e bisedës ishte tjetër: **S.T.** gjoja po përpiquej të bindte **F.B.** të mos takohej më me **M.B.**, dhe prandaj, në atë kontekst, nuk mund të kuptohet pse **F.B.** do të përpiquej të theksonte faktin se nuk ishte e obliguar të shkonte me **M.** (gjë që do të ishte jo vetëm e qartë, por vetë arsyeja për përpjekjen e **S.T.** për të bindur **F.** ta ndërpresë atë marrëdhënie)³²;
- Dëshmitë e dëshmitarëve **A.**, **V.** dhe **A.B.** bëjnë të qartë se këta kanë një dijeni vetëm *de relato* të fakteve, sidomos sa i përket lidhjes së supozuar të dashurisë (duke qenë burimi kryesor i informatave dëshmitarja **S.T.**). Përpos kësaj, dëshmitari **A.B.** përmend një bisedë që supozon të jetë zhvilluar në mes tij dhe të vëllait, **M.**, ku i cili i kishte thënë se **F.B.** po i shkonte prapa dhe jo anasjelltas).
- Dëshmia e , në veçanti, nuk përmban në vetvete ndonjë vlerë dëshmuuese. Ai në mënyrë të qartë deklaroi se nuk ka ditur gjë për lidhjen e supozuar të dashurisë deri në ditën e vrasjes dhe se të gjitha i kishte mësuar nga të afërmit (**S.T.** në veçanti). Jo vetëm se ky shfaqte një tendencë energjike për të bërë deklaratat të rrembyera dhe të pasakta kundër **F.B.**³³, por kishte edhe agresivitet të përgjithshëm kundër saj gjatë gjithë shqyrtimit kryesor;

²⁹ P.sh. **R.B.** kësaj radhe përfundoi dukë thënë se nuk kishte parë se çfarë po bënin e pandehura dhe **M.B.** ngase gjoja ishin prapa kolibës së qenit.

³⁰ Shih proces-verbalin e seancës kryesore të datës 22 shtator 2009, faqe 17.

³¹ P.sh. shih deklaratat e **S.T.**, seanca më 15.9.2009, faqe 12.

³² Në të kundërtën, Trupi Gjykues beson se dëshmia e **S.T.** do të ishte një sqarim i logjikshëm nëse konsiderohet si përpjekje e shtuar që Trupi Gjykues të mos bësojë versionin e **F.B.**

³³ Kështu ishte rasti p.sh. për fotografinë lakuriqe të **F.B.** Sa i përket kësaj, me vendosmëri të madhe insistonte se fotografia është bërë në shtëpinë e tij dhe të **M.B.**, por kjo rrethanë është

- Dëshmitarja **S.T.** (siç u tha, burimi kryesor për informata lidhur me lidhjen e dashurisë) kundërshton vetveten sa i përket qëndrimit të saj të përgjithshëm ndaj **F.B.** dhe sjelljes së saj sa i përket lidhjes së supozuar të dashurisë. Në fakt, në njërën anë thoshte se kjo lidhje e dashurisë ishte neveritëse për të (deri në pikën ku deklaroi se kishte vjellur me t'i parë duke u puthur) dhe që disa herë ishte përpjekur të bindë **F.** të mos i shkonte **M.B.** pas. Në anën tjetër dhe në mënyrë kundërtë, ajo dukej se mbështeste lidhjen e dashurisë (p.sh. pirja e kafesë me **F.** në shtëpinë e **M.** në kohën kur **F.** supozohet se po e vizitonte, furnizimi i saj me SIM kartelë në mënyrë që t'i mundësonte kontaktin me **M.**, diskutimi i detaleve të marrëdhënies³⁴ me të pandehurën). Të njëjtat kundërshtime shfaqen kur **S.T.** deklaroi se nuk mund t'i shihte dot takimet e **F.** dhe **M.** (kjo e detyroi atë që të vjellte dhe të kthente kokën në anën tjetër), ndërsa në anën tjetër deklaroi se e dinte se **F.** dhe **M.** takoheshin rregullisht ngase ndiqte "çdo moment"³⁵. Një kundërshtim tjetër shfaqet sa i përket faktit të supozuar se **M.** dhe e pandehura kishin hapur një vrimë në rrjetin nën dritaren e deposë. Në njërën anë, dëshmitarja deklaroi se dritarja në fjalë është hapur rreth pesë muaj para vrasjes së **M.B.**³⁶. Në anën tjetër, ajo menjëherë tha se vrima e tillë ishte mbyllur nga ata rreth pesë muaj para vdekjes së **M.B.** Menjëherë pas kësaj (sërisht duke bërë zmadhime të jashtëzakonshme) duke shtuar se **F.** dhe **M.B.** "kishin hapur shumë vrima, gjithandej"³⁷.

diskredituar në mënyrë radikale nga të gjithë dëshmitarët e tjerë të marrë në pyetje gjatë seancës më 1.12.2009.

³⁴ Shembulli i vrimës që supozohet të jetë hapur në rrjet nën dritaren e depos, proces-verbali i shqyrtimit kryesor, më 16 shtator 2009, faqe 10. Akoma më kundërtë, dëshmitarja deklaroi se (pavarësisht nga kundërtënia e saj lidhur me lidhjen e dashurisë, deri në pikën e "të vjellurave") me rastin e hapjes së supozuar të vrimës, gjatë bisedës me **F.B.**, kjo e fundit t'i ketë thënë "do të ishte mirë që **M.** të priste rrjetin në atë dritare, në katin e parë që të mos shihej nga fqinjët".

³⁵ Trupi Gjyqës ballafaqoi dëshmitaren me këtë qëndrim të dykuptimtë, mirëpo ajo nuk dha ndonjë përgjigje të saktë sa i përket këtij kontestimi. Vlen të ceket se **S.T.** kundërshtoi edhe vetveten (shih proces-verbalin e shqyrtimit të dytë kryesor) me rastin e fjalëve të thëna zyrtarit të policisë që erdhi në shtëpinë e saj në mëngjesin e vrasjes. Së fundi, Trupi Gjyqës ballafaqoi **S.T.** me kundërshtimet që dalin nga deklaratat e saj dhënë në Prokurori dhe asaj para Trupit Gjyqës lidhur me kohën e takimeve në mes të **F.** dhe **M.** (para Trupit Gjyqës ai deklaroi se janë takuar pa caktuar kohën ndërsa në Prokurori, kishte deklaruar se janë takuar në 12 të ditës). Shihni proces-verbalin e seancës kryesore më 16 shtator 2009, faqe 18.

³⁶ Shih faqe 10 të proces-verbalit më 16 shtator 2009.

³⁷ Është e qartë që as kjo fjalë e dëshmitares nuk është e besueshme.

Emri: **Aktgjykimi,**

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
 Faqe: 21 of 27

- Të gjithë dëshmitarët e përmendur më lart i përkasin familjes së **M.B.**, gjë që rrit mundësinë e një komploti kundër **F.B.**. Ndërsa Trupi Gjykses nuk mund të mos vë re ekzistencën e një motivi të përshtatshëm që pala e dëmtuar të kundërshtojë versionin e **F.B.**, duke pasur parasysh sjelljen e turpshme dhe kriminale të **M.B.** në versionin e **F.B.**.
- Sa i përket dorëzimit të supozuar të SIM kartelës së dorëzuar nga **S.T.** **F.B.** në mënyrë që kjo e fundit të mund të mjaftonte kontaktet me **M.B.**, duhet cekur që:

- Dëshmitarja **S.T.** kundërshtonte shumë vetveten në çështjen nëse e ka ditur (para se ta blinte) se **F.B.** i duhej SIM kartela për të kontaktuar **M.B.**³⁸.
- **S.T.** dhe **V.B.** nuk ofruan sqarime të mjaftueshme për supozimit se SIM kartela, të cilën **S.T.** i dha **F.B.** ishte në kornizën e njëjtë të plastikës, të dorëzuar Trupit Gjykses. Për më tepër, nuk dihet nëse numri i telefonit (044431563) i shënuar me dorë në letrën bashkangjitur kornizës plastike i referohet kartelës në fjalë; prandaj, nuk është e sigurtë nëse kartela e përmendur nga dëshmitari para Trupit Gjykses është po ajo e dhënë **F.B.**;
- Edhe SIM kartela në fillim i është dorëzuar asaj, nuk dihet nëse mu këtë SIM kartelë e ka përdorur *de facto* vetëm **F.B.** gjatë këtyre viteve.

Si pasojë, Trupi Gjykses beson se nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar se numrat e telefonit të regjistruar në numrin 044431563 u referohen kontakteve ndërmjet **F.** dhe **M.B.**

- Përpos kësaj, duhet të ceket që rikrijimi alternativ i propozuar nga pala e dëmtuar (p.sh. vrasja e **F.B.** jo nga **M.B.**, por nga **V.B.**) nuk konfirmohet nga asnjë element tjetër përpos nga dëshmitë e dhëna nga anëtarët e vetë familjes së të dëmtuarit (të cilët fare nuk i referohen vrasjes, por vetëm sjelljes së mëparshme).

³⁸ Në çastin e parë, ajo deklaroi se **F.** i kishte thënë se SIM kartela do të përdorej për të thirrur **M.** ("Kryetari i Trupit Gjykses: A ju tha arsye pse **F.B.** e donte një gjë të tillë apo jo? **S.T.**: Për të folur me **M.** Kryetari i Trupit Gjykses: A e pyetët pse nuk e përdorte telefonin e vet? **S.T.**: Ajo tha se ata do të mund të ma shihnin listën e thirrjeve"). Sapo Kryetari i Trupit Gjykses e ballafaqoi atë me faktin e pabesueshmërisë, me kundërthëniet e saj për të qenurit kundër lidhjes së dashurisë, ajo ndryshoi versionin dhe tha që vetëm më vonë **F.B.** i tha se i duhej SIM kartela për të thirrur **M.**

- Përfundimisht duhet të shtohet se ka asnjë provë specifike që dëshmon se V.B. ishte në dijeni për lidhjen e supozuar të dashurisë e as për përdhunimet e supozuara.

Kjo nënkupton që nuk ka prova (por vetëm spekulime) që mund të sjellin deri të krijimi i motivit për të vrarë³⁹. Fakti se V.B. ishte i pranishëm në kompleks (pra, në punëtori, sipas versionit të tij të ngjarjeve) kur ndodhi vrasja, sigurisht që nuk mjafton për ta dënuar atë. Prandaj, pjesëmarrja e tij në vrasje nuk është asgjë përpos një mundësi ligjore bazuar në provat e mbledhura.

3.4.3. Si përmbledhje, Trupi Gjykes është i mendimit si në vijim:

3.4.3.1. Sa u përket rrethanave të vlerësuara më lart, rrethanave të përcaktuara nën 3.3.2 dhe versionit alternativ të përshkruar më 3.3.2.1 ff., Trupi Gjykes pajtohet se këto rrethana kontribojnë për të hedhur dritë në pranimin e fajit, pra në motivet për të vrarë dhe arsyen pse (si dhe mënyrën) M.B. u fut në shtëpinë e F.B. (a ishte i ftuar apo i tërhequr aty nga e pandehura apo nga dikush tjetër? A hyri në shtëpinë e saj me vetë-iniciativë?).

3.4.3.2. Edhe pse këto pjesë të pranimit të fajit nuk kanë rëndësi të madhe vendimtare kundër përgjegjësisë së vetë-akuzimit të F.B., duke pasur parasysh elementet e fuqishme të jashtme që konfirmojnë pranimin e fajit, kundërshtimet e lartpërmendura si dhe elementet e dyshimta të dëshmimeve të cituara në 3.4.2. ff., Trupi Gjykes vë re se

3.4.3.3. edhe nëse këto rrethana do të kishin relevancë më të madhe dhe nëse do t'i besohej palës së dëmtuara lidhur me çështjen e lidhjes së dashurisë ndërmjet F. dhe M.B., kjo nuk do të mjaftonte për të përjashtuar përgjegjësinë e F.B. për vrasje.

Në rast të tillë, arsyet logjike dhe faktike do t'i falnin besueshmëri një pjese (p.sh. përgjegjësisë për vrasje) dhe jo tjetrës (p.sh. përdhunimeve)⁴⁰. Në fakt, sa i përket kësaj, duhet cekur se:

³⁹ Nuk mund të konsiderohet si e vërtetë ajo që është thënë nga pala e dëmtuar ("edhe lopët e kanë dëmtuar se ka lidhje dashurie aty") pasi që vetë ai më vonë e pranoi para Trupit Gjykes se as ai nuk e kishte ditur për përfshirjen e të birit në këtë lidhje dashurie.

⁴⁰ Në rast të arsyeve faktike dhe atyre logjike, duket të ceket që në princip është e mundshme të besohet vetëm një pjesë e pranimit të fajit dhe jo të tjerat.

A. Edhe pranimi i ekzistencës së lidhjes së dashurisë në mesin e tyre nuk rrëfen fare për kohëzgjatjen apo rezultatin e saj. Në veçanti, nuk përjashton eventualitetin e një epilogu të dhunshëm apo edhe tragjik për shumë arsye⁴¹;

B. Po të ishte rasti ky, përshkrimi i sjelljes së dhunshme të F.B. nga ana e M. do të ishte i dobishëm për të ngase do të rriste gjasat e mbrojtjes. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së mëparshme të F. dhe M., Trupi Gjykes është i mendimit se do të ishte e logjikshme të pranohet se ajo shpалosi një rrëfim që përmban përdhunime dhe kërcënime, në mënyrë që të ketë një mundësi më të mirë që të (a) provojë strategjinë e mbrojtjes së nevojshme, (b) të shpëtojë reputacionin e saj para familjes dhe shoqërisë dhe (c) të parandalojë hakmarrjen (e dhunshme) nga i shoqi.

3.4.3.4. Provat e përshkruara më lart janë të qarta sa i përket F.B. duke shtënë tre here në M.B. dhe pasoja e shkaktit të vdekjes së këtij të fundit. Akti i të shtënave ishte vullnetar dhe kishte për qëllim vrasjen. Trupi Gjykes vlerëson se kushtet për mbrojtje të nevojshme, të pretenduara nga e pandehura në pranimin e saj të fajit, nuk plotësohen.

Kjo është e qartë në versionin e dhënë nga F.B. lidhur me incidentin e 34.5.2007, i cili përmbledhet si në vijim:

- Ajo pa M.B. duke u futur në shtëpi dhe duke u nisur drejt dhomës së epërme (odës)
- Ajo "humbi" dhe deshi që sjelljeve të M.B. ndaj saj t'u vie fundi;
- Ajo u armatos me armën e të shoqit, e mbushi atë si dhe futi fishekë shtesë në xhep
- Ajo shkoi në odë dhe pa M.B. te dritarja
- Ajo e qëlloi nga një distancë prej disa metrash.

Duhet të theksohet se versioni i pranimit të fajit para Prokurorit Publik është shumë më i sintetizuar dhe përmend praninë e një thike pranë trupit të viktimës. Versioni i dhënë para Trupi të parë Gjykes përmban më shumë detale dhe përmbledhet si në vijim:

- Kur M. e pa atë me armë, ai tha: "bushtër, ta merr mendja të më frikësosh?" dhe iu afrua duke nxjerrë thikën dhe duke u përpjekur t'i marrë armën;
- F.B. i tha që të zbrapset më shumë se një herë
- Eventualisht, ajo shtiu me armë, por vetëm për ta frikësuar dhe jo për ta vrarë

⁴¹ P.sh. xhelozia, apo vendimi i njëjës palë për të përfunduar lidhjen apo shantazhi (gjë që do të sqaronte praninë e fotografisë lakuriqe të F.B. në kamerën e M.);

- Ajo nuk ishte në gjendje të përshkruajë se çfarë ndodhi pas të shtënës së parë.

Trupi Gjykues beson se kushtet për mbrojtje të nevojshme nuk janë përmbushur, duke u mbështetur në rrethanat e nënvizuara gjatë pranimit të fajit nga ana e **F.B.**, siç është konfirmuar nga një pjesë e provave materiale dhe nga eksperiza se:

- e pandehura fillimisht nuk ishte sulmuar nga **M.B.** Ajo e kishte ndjekur atë në odën e burrave;
- ajo kishte bërë këtë pasi kishte mbushur pushkën e gjuetisë si dhe xhepin me fishekë shtesë;
- në momentin e të shtënave, ajo nuk kishte asnjë pengesë për të vajtur tek dera; distanca mes saj dhe **M.** ishte (sipas fjalëve të njëjta të të pandehurës) 2 metra (ose të paktën dy hapa, siç është deklaruar më vonë para Trupit Gjykues): pra një mundësi për të gjetur rrugëdalje tjetër pa qenë nevoja e vrasjes së viktimës;
- ajo nuk u kufizua me një të shtënë, ajo shtiu tre herë;
- të tre të shtënat u drejtuan në pjesët vitale të trupit;
- pas dy të shtënave të para, **F.B.** rimbushi armën dhe qëllloi përsëri viktimën në kurriz.

Trupi Gjykues është i mendimit se rrethanat faktike e lartpërmendura nuk përputhen me mbrojtjen e nevojshme. Përkundrazi ato konfirmojnë ekzistencën objektive të qëllimit për të vrarë. Në veçanti, fakti se ishin disa të shtëna, fakti se e shtëna e dytë dhe e tretë u qëlluan nga e pandehura kur viktimë kishte rënë në tokë⁴², fakti se ajo ka rimbushur armën dhe ka qëlluar përsëri; të gjitha këto janë rrethana që na bindin bindshëm, dhe që çojnë Trupin Gjykues të pranojnë ekzistencën e dashjes për të vrarë⁴³.

4. Dënimi

Kur vendos për dënimin gjykata duhet të marrë në konsideratë mënyrën e kryerjes së krimit si dhe personalitetin e të pandehurit. Dënimi duhet gjithashtu të ketë funksion parandalues kundër krimeve të mëtejshme si dhe të jetë një dënim në përputhje me veprën penale të kryer.

⁴² E pandehura e ka pranuar këtë në mënyrë të veçantë gjatë pranimit të fajit herën e dytë; ajo ka thënë se **M.** u rrëzua pas të shtënës së parë. Është e qartë se në një situatë të tillë, kur i pandehuri ishte i shtrirë me fytyrë në tokë—përdhe, fakti se **F.B.** në vend që të largohej nga dhoma e ka qëlluar dy herë mbi kurriz është shenjë e qartë e ekzistencës së vrasjes *mens rea*.

⁴³ Ky përfundim nuk dobësohet as nga prania e thikës pranë trupit të viktimës: mbi këtë thikë Policia nuk ka gjetur shenja gishtash. Trupi gjykues është i mendimit se renditja e lartpërmendur e ngjarjeve bën të qartë praninë e qëllimit për të vrarë, edhe duke pranuar se viktimë kishte pasur një thikë.

Në lidhje me mënyrën e kryerjes dhe karakteristikat objektive të krimit të kryer nga **F.B.**, duhet të merret parasysh se e pandehura ka dalë para viktimës me armë të mbushur, pasi e ka ndjekur atë në dhomën ku do të kryhej krimi. Gatishmëria e të pandehurës për të vrarë konfirmohet nga fakti se megjithëse ajo ishte në gjendje të largohej nga vendngjarja pa vrarë viktimën ajo jo vetëm qëlloi njëherë duke shënjuar trupin, por gjithashtu rimbushi armën dhe qëlloi dhe për herë të tretë kur viktima kishte rënë përdhe. Këto rrethana janë relevante kundër të pandehurës dhe kanë bërë që Trupi Gjykses të përjashtojë zbatimin e dënimit më minimal.

Njëkohësisht, Trupi Gjykses nuk mund të mos marrë parasysh rrethanat në favor të të pandehurës:

- Praninë e episodeve serioze të dhunës, në të kaluarën, nga ana e **M.B.** kundër saj. Kjo bën që të kuptohet fakti se **F.B.** nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë sjelljen që duhet të kishte në rrethanat e caktuara;
- Fakti se, me sa duket, **M.** kishte nxjerrë një thikë.

Dy rrethanat e lartpërmendura, siç është theksuar dhe më parë, duhet të konsiderohen si të provuara, pavarësisht se ka aspekte të paqarta. Këto rrethana, në lidhje me dënimin, janë në favor të të pandehurës. Megjithëse këto rrethana as që i afrohen mbrojtjes së nevojshme ato kanë relevancë pozitive në lidhje me personalitetin e treguar nga e pandehura dhe sa në gjendje ishte ajo për të kryer një vepër penale.

Në fund, duhet të merret parasysh se e pandehura e ka pranuar fajin dhe se ka pasur një sjellje perfekte gjatë gjykimit. Ajo nuk ka dënime të mëparshme penale (përveç, sigurisht, dënimit për posedim të paautorizuar të armëve, të marrë gjatë të njëjtës procedurë penale).

Trupi Gjykses konsideron se, duke marrë parasysh rrethanat dhe parametrat e lartpërmendura, dënimi me dhjetë (10) vjet burgim është i përshtatshëm.

Koha e kaluar në paraburgim është llogaritur tashmë për veprën penale për të cilën është marrë vendimi i mëparshëm.

5. Kërkesë pronësore

Gjatë seancës së parë pala e dëmtuar **A.B.** ka kërkuar mbrojtje ligjore të të drejtave të tij gjatë këtij gjykimi.

Vrasja e djalit është vepër e rëndë penale duke marrë parasysh lidhjen e ngushtë me viktimën. Në këtë rast vrasja e **M.B.** është për **A.B.** humbja e një bashkëpunëtori në ndërmarrjen e çila drejtohet nga familja. Kësaj duhet t'i shtohet edhe dhimbja dhe vuajtjet që lidhen me këtë rast (dhe këto të fundit bëhen dhe më

Emri: *Aktgjykimi,*

Përkthyer nga:

EL, AS, ARW, SC
Faqe: 26 of 27

të forta kur marrim parasysh se M. dhe A.B. etonin shumë afër, në të njëjtën shtëpi).

Për këtë arsye A.B. i jepet e drejta e kompensimit të përshtatshëm për dëmin e pësuar.

Mirëpo, procedura e provës nuk i ofroi Trupit Gjykses prova të plota të dëmtimit të pësuar nga pala e dëmtuar.

Sidoqoftë, është e nevojshme që t'i bëhet një kompensim i pjesshëm, duke e udhëzuar atë që të përcaktojë saktë pjesën tjetër të kërkesës për kompensim nëpërmjet padisë civile.

Trupi Gjykses vlerëson si të përshtatshëm që e pandehura t'i bëjë pagesën e pjesshme prej EUR 10.000,00 palës së dëmtuar.

Për pjesën tjetër, pala e dëmtuar udhëzohet që të ngrisë padi penale te gjykatësi civil, me ç'rast do të dorëzohen të gjitha provat dhe do të sjellet një vendim për kompensim të plotë.

Prandaj, është vendosur si në dispozitiv.

Përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtëse

Kryetari Ndërkombëtar i Trupit Gjykses

Vlora Johnston

Ferdinando Buatier de Mongeot

Keshilla juridike

Në pajtim me Nenin 400, KPPPK, ankesa duhet të deklarohet brenda 8 ditëve pas shpalljes së këtij vendimi.

Në pajtim me Nenin 407, KPPK, ankesa ushtrohet nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Pejë në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e këtij vendimi.

Data 14 dhjetor 2009.

P. Nr. 145/2009

Emri: Aktgjykimi,

Përkthyer nga:

Ne emer te përkthyesve vërtetohet:
Illir Venhari EULEX1703




EL, AS, ARW, SC
Faqe: 27 of 27

Ref: 2007-HRP-022

2007-DE-491

Vrasje

fsh. Gjurgjevik i madhë KK-Klinë



Perpiloti Helmesi
Enis Boshtrakaj #55854

03

03

2007-DE-491

Skica nuk eshte e shkallezuar

Skicen e perpiloi:
Blerim Tigani #5748

Hyrja
(Dera e oborrit)

